



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit e mbajtur me datë **05.02.2019** me fillim në ora **10.15**, këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete mbledhjes z. Bajram Morina. **Kryesuesi** – Përsëritës përfaqësuesit e OSBE-së, UNMIK- ut, SHL- Kosova, juve anëtarë të Komitetit për Komunitet dhe të gjithë të pranishmit. Konstatohet se kemi kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019,
3. Të ndryshme.

E qes në aprovim rendin e ditës, konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

E qes në votim procesverbalin: Konstatohet se pika e parë e rendit të ditës është aprovuar, kalojmë në pikën e radhës:

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës për Komunitete për vitin 2019.

Në qoftë se keni ndonjë propozim apo koment ju lutem mund të merrni fjalën.

Ali Zhuniqi - Përsëritës për të gjithë të pranishmit, është lexuar I gjithë plani, sa I përket përpilimit për 2019 nuk kam diçka për të shtuar janë diku rreth tetëmbëdhjetë pika, për të cilat do të merremi me aktivitete të punës dhe shpresoj që do ti bashkë rendojmë të gjitha këto aktivitete në mënyrë që ti ndihmojmë sa do pak komitetet në komunën e Rahovecit. Tek pika e 9 dhe 11 janë disa takime me drejtor të arsimit, shëndetësisë urbanizmit dhe të shërbimeve publike, dhe të tjerë sipas nevojës. Jam I interesuar caktimi I takimit shkon në nëpërmjet zyrës së komunës apo informohemi me e-mail.

Kryesuesi – Z. Ali jam duke e theksuar në pikën e 9 dhe 11 për takime me drejtorin të arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve publike, ne kemi formuar një planë vitin e kaluar që kemi i zgjedhur disa anëtarë nga ana e juaj dhe nga ana ime, një lloj komisioni dhe besoj në bazë të mënyrës së zgjedhjes duhet të shkonin përmes drejtorisë së arsimit, jo direkt nëpër shkollë por duhet të jetë përfaqësuesi I drejtorisë së arsimit, mendoj se është më efikase kështu.

Mirjetë Krasniqi - Përsëritës për të gjithë të pranishmit, sa i përket planit të punës, unë mendoj që duhet patjetër ta ketë ky komitet, ne kemi marrë pjesë në punëtorinë javën e kaluar dhe kemi dhënë kontribut aq sa kishim mundësi, sa I përket planit nuk kam asgjë kundër por dihet që gjatë seancave të vitit 2019 mund të shtohet eventalisht edhe ndonjë pikë sipas nevojës. Ky plan mendoj që duhet të aprovohet patjetër sot këtu në komitet dhe të dërgohet në kuvend për miratim.

Kryesuesi – E qes në votim Planit të Punës për Komunitete për vitin 2019: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës.

3. Të ndryshme.

Dushan Stojanoviç - Përsëritës për të gjithë të pranishmit, ndoshta nuk është vendi i duhur për të shprehur shqetësimin e banorëve të komitetit serb, mirëpo ka të bëjë lidhur me pllakën përkujtimore e cila gjendet në rrugën Rahovec - Zoqishtë e disa gazetarëve serb, kjo pllakë po shkatërrohet kështu

që e ritheksoj që kjo nuk është e pëlqyeshme në komitetin tonë edhe pse kjo çështje do të ngritët në këshillin komunal për siguri, vetëm desha të ju përkujtoj se kemi të bëjmë me një pllakë përkujtimore dhe nuk ka nevojë të bëhet një gjest i tillë, është një shqetësim i banorëve të komitetit serb.


Kryesuesi - Faleminderit siç e shihni në këtë planë që e kemi formuar së bashku, kryesuesi përmes KSB-së do të kërkoj bashkëpunim të ndërsjellët.

A ka dikush të shtoj diçka tjetër sa i përket kësaj pike, nëse jo ju faleminderit për të gjithëve për kontributin e dhënë sot, me kaq mbledhja ka përfunduar shihemi në takimet e radhës.

Mbledhje ka përfunduar në ora 10:30

Procesmbajtësi,

Skender Hamza

 Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina